

# AKT THEMELUES

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“BSO” SH.P.K.

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “PërQendrën Kombëtare e Biznesit” dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnet të lirë, të shprehur nënshkrimin e Aktit Themelues :

Znj. Elisa Pjetergjoka, e bija e Bibe, lindur me, 16/01/1996, banues ne Tirane me ID: J651160591  
Z. Bledar Pjetergjoka, i biri i Bibe, lindur me, 25/07/1998, banues ne Tirane me ID: J80725076H  
Sot date 18 /05/2023 vendosëm të krijojmë shoqërine me përgjegjesi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

## FORMIMI

### NENI 1

Formohet shoqëria “**BSO**” sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

## SELIA E SHOQERISE

### NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private “**BSO**” sh.p.k. do të jetë : Rruga “Mustafa Lleshi” Tirane, Ndertesa nr 3, Tirane.

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

Sherbime dhe konsulencje financiare,juridike,marketigu,mbrojtje e markes tregtare,sherbimeve dhe dizenjo, te teknologjise se informacionit, veprimitari ne fushen e kultures,artit,reklamave, organizim dhe menaxhim te aktiviteve, konferanca, dasma, ditelindje, pervaletore, perurime dhe ngjarje te tjera te rendesishme ne te gjithe komponentet perberes.

Shoqeria per permbyshjen e qellimit te saj mund te lidh marrdhenie nenkontraktuale me persona te trete. Punime per shtypshkrime, botime, website, dizanjime dhe printime te ndryshme. Sherbime koktejli dhe Kateringu. Tregti, prodhim me shumice dhe pakice nepermjet cdo forme te shit-bljerjes te dekoreve, skenografive, aksesoreve, mobiljeve dhe cdo materiali qe do te duhet per kete qellim. Me qellim kryerjen e aktiviteve te mesiperme Shoqeria mund te ushtroje veprimtarine e saj ne Shqiperi dhe jashte saj e te kryeje cdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes, te ngashem, plotesues apo te dobishem per permbyshjen e objektit te saj. Te zoteroje direkt ose indirekt pjesemarrje ne shoqeri dhe/ose sipermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitete te njejta, te ngashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose qe mund te ndihmojne ne realizimin e objektit te Shoqerise. Koncerte dhe spektakle, show te te gjitha zhanreve me gjithe perfshirje te grupmoshave te ndryshme. Panaire dhe eksposita. Aktivitete te ndryshme bashkepunimi ne Ballkan, Europe e me tej. Sherbime audio, video, foni profesionale, ndriçim profesional, ledwalle etj. Organizim i pritjeve protokollare. Shitje artikuash te ndryshem kancelarie, pajisje zyre,tregetim i artikujve sportiv, librave artistike dhe shkolllore dhe pajisje te ndryshme informatike, sisteme komunikimi,printer, tonera duke ofruar dhe siguruar cdo sherbin lidhur me mirembajtjen, transportin dhe informacionet per instalimin e pajisjeve te siperpermendura, por pa u kufizuar ne to. Prodhim, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve te reklamave, tabelave ndriçuese dhe jo ndriçuese, tabela me alukobond, punime plexiglassi, germa 3D, reklama ne seri, reklama elektronike, printime dhe brandim fasadash te brendshme dhe te jashtme, brandim automjetesh, brandim karburanti, veshje fasade, stenda dhe artikuj promocioni, tabela sinjalistike per ambjente te brendshme dhe te jashtme, modifikim dhe adaptim reklamash dhe tabelash te ndryshme, arredim ambjentesh, etj. Importin e te gjitha lendeve te para, materialeve dhe pajisjeve per realizimin e produkteve te mesiperme, tregetimin e tyre brenda vendit, si edhe eksportin e tyre ne vendet e tjera. Importin e ndriçuesave te ndryshem, Led ose jo Led, dhe tregtimin e tyre. Sherbime te ndryshme marketingu, si dizajn, printime te ndryshme, si kartevizita, fletepalosje, banera, organizim aktivitete te ndryshme promocionale, etj. Projekte, ideime, zberthime teknike dhe zbatime te ndryshme. Krijim, pergatitje, e shtypshkrimeve e printimeve te materialeve te karakterit te rezervuar, konfidencial dhe sekret te lejuar nga ligji, ideim, projektim, perpunim, realizim, montim mobiljesh e pajisjesh te brendshme, arredim ambientesh. Studim, projektim, prodhim, montim, tregtim dhe zbatim I sinjalistikes rrugore vertikale dhe horizontale,

ndriçuese dhe jondriçuese, vijezime, bariera rrugore, konstruksione metali, rafte metali, ekspositor, kosha, stola, kuti, si dhe produkte te tjera te ngjashem". Tregti me shumice dhe pakice e materialeve dhe lendeve te para per reklama, mallrave industriale, produkte ushqimore, pijeve, produkte higjenike, pastrim dezinfektim, detergjente, sherbime higjeno-shendetesore, makineri e pjese kembimi, pajisje elektrike, hidraulike, bojra per lyerje, investime ne fushen e ndertimit etj. printim, dizajn, prodhim dhe stampim ne cante letre, tullumbace, gota, uniforma e shume produkte te tjera ; Sherbim hoteli, restoranti, bari. Tregtim lulesh dhe pemesh dekorative, sherbim dekorimi, gjelberimi. sherbime konsulencë dhe asistence teknike ne favor te subjekteve private dhe shteterore, perfaqesimi i kompanive vendase apo te huaja; ndermjetesime

#### NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

#### KAPITALI I SHOQERISE

#### NENI 6

Kapitalithemeltar i shoqërisë tregtare private "BSO" sh.p.k. do të jetë **200.000** (dyqind mijë) lekë.

Znj. Elisa Pjetergjoka	100.000
Z. Bledar Pjetergjoka	100.000

#### Perkatesisht

Znj. Elisa Pjetergjoka	50%
Z. Bledar Pjetergjoka	50%

Kapitali përbëhet nga 2 kuota, secili nga ortaket ka nga 1 kuote dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100 000** lekë.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaket duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potentialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administrator I saj, Znj. Elisa Pjetergjoka , e cila është përfaqësuese ligjore e saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakeve themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortaket themelues kane të drejtë të emërojnë dhe administrator të tjerë të vlerave material të shoqërisë. Kane të drejtë të caktojne financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.



NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjisacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrithin e saj.

NENI 13



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 14


Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare  
**"BSO"**sh.p.k.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**"BSO"**sh.p.k

Elisa Pjetergjoka



Bledar Pjetergjoka

